



KOMUNA E MALISHEVËS



# BULETINI

Buletini nr. 159- Shkurt- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje nga aktivitetet e zhvilluara gjatë muajit shkurt



## Permbajtja:

Buletini nr. 159- Shkurt- 2017- Zyra për Informim Publik - <a href="https://kk.rks-gov.net/malisheve/">https://kk.rks-gov.net/malisheve/</a>	1
Mërgimtari Bashkim Shala, pajisë me kompjuterë edhe një shkollë .....	3
Malisheva në përkrahje të Ramush Haradinajt .....	3
Malisheva, ndër komunat më të mira në realizimin e buxhetit .....	5
Ka filluar realizimi i disa projekteve .....	6
Ka filluar ndërtimi i tri rrugëve në Bellanicë .....	7
Trotuar për nxënësit e Carrallukës .....	8
KPF mbajti mbledhjen e dytë për këtë vit, ku dha disa rekomandime.....	9
Sot ka filluar faza e dytë e vizitave sistematike në shkollat e Malishevës.....	9
Formohet sindikata e punëtorëve të administratës komunale.....	10
Aktivitete të shumta në prag të shënimit të Pavarësisë.....	11
Malisheva shënoi nëntë vjetorit e Pavarësisë .....	11
Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Malishevë, shënoi ditën e themelimit .....	14
Filloi hapja dhe rregullimi i dy rrugëve në Pagarushë .....	15
KKSB miratoi planin e punës për vitin 2017.....	16
U mbajt mbledhja e dytë e KK të Malishevës .....	16
Begaj në Dusseldorf, prezantoi ofertën e Malishevës për investime.....	17
Shënohet rasti i parë i thumbimit të rriqrave për këtë vit .....	18
Begaj, takoi humanistin gjerman Rudolf Broer.....	19
Sunderni dhe Malisheva, vazhdojnë bashkëpunimin e mirë.....	19



## Mërgimtari Bashkim Shala, pajisë me kompjuterë edhe një shkollë

### Malishevë, 1 shkurt



Mërgimtari nga Guncati i Malishevës, Bashkim Shala, i cili jeton në Zvicër, ka ndihmuar edhe një shkollë tjetër, me kompjuterë, për lëndën e informatikës, përkatësisht, ka pajisur kabinetin e informatikës, në Sh.F.M.U. “Hilmi Hoti” në Carrallukë, me dhjetë kompjuterë. Kohë më parë, mërgimtari Shala, kishte pajisur me kompjuter edhe shkollën e fshatit Guncat.

Ky donacion është mirëprit nga nxënësit, personeli arsimor dhe nga Drejtoria e Arsimit dhe Edukim në Komunën e Malishevës. DKAE me këtë rast e falënderon mërgimtarin Bashkim Shala, për donacionin e radhës, pasi përmes këtij donacioni, është duke kontribuar në rritjen e cilësisë në shkollat e Komunës së Malishevës.

Me rastin e dhurimit të kompjuterëve për shkollën “Hilmi Hoti”, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, Avdi Morina, e ka falënderuar mërgimtarin Shala dhe e ka vlerësuar lartë kontributin e tij, për angazhim në krijimin e kushteve më të mira për nxënësit e Komunës së Malishevës, në procesin e mësimnxënies dhe edukimit.

Nga ana tjetër, mërgimtari Bashkim Shala, premtoi se “nuk do të jetë donacioni i fundit, por do të angazhohet në sigurimin e donacioneve tjera për shkollat e Komunës së Malishevës”.

## Malisheva në përkrahje të Ramush Haradinajt

### Malishevë, 2 shkurt

Sot në Malishevë, organizuar nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe Komuna e Malishevës, është mbajtur një marsh protestues, kundër arrestimit të ish kryeministrit të Kosovës, gjeneralit Ramush Haradinaj. Në këtë marsh, u kërkua lirimi i Ramush Haradinajt, pasi lufta e tij dhe e



UÇK-së, ka qenë luftë e pastër dhe çlirimtare, luftë e cila është dëshmuar shumë herë. Në këtë marsh, u kërkua nga institucionet vendit që ta ndërpresin dialogun me shtetin serb, deri në njohjen e shtetësisë së Kosovës dhe heqjen e akuzave ndaj çlirimtarëve.

Në këtë marshim, që filloi nga hyrja e Malishevës, e deri në qendër të qytetit në “Sheshin e Dëshmorëve”, morën pjesë mijëra qytetarë të

Komunës së Malishevës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, strukturat komunale të Malishevës, si dhe përfaqësuesit e subjekteve politike në Malishevë dhe veteran të luftës së UÇK-së.

Në fjalimin e tij, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, tha se “liria jonë, nuk ka kuptim, kur neve na burgosen çlirimtarët”. “Ne i bëjmë thirrje shtetit mik të Francës, që ta liroj Ramush Haradinajn, dhe të mos bien në kurthet e shtetit serb”. Mazreku, gjithashtu foli edhe për figurën e Ramush Haradinajt dhe angazhimin e tij ushtarak dhe politik.

Ndërsa deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e “NISMA për Kosovën”, Enver Hoti, tha se “Ramush Haradinaj, është vet liria”. “Shprehim indinjatën tonë për arrestimin e Ramush Haradinajt, ndaj të cilit përfundimisht në vitin 2012, në Hagë, është vërtetuar se lufta e tij dhe e UÇK-së, ka qenë çlirimtare dhe e pastër. Ne ju bëjmë thirrje Francës dhe INTERPOL-it, që të mos bien në kurthet e mashtrimeve serbe”, tha mes tjerash deputeti Hoti.

Shefi i grupit parlamentar të AAK-së, në Kuvendin e Kosovës, Pal Lekaj, pasi i falënderoj qytetarët e Malishevës, për mbështetjen e dhënë, tha se “Ramushi, Fatmir Limaj, Lahi Ibrahimaj dhe të tjerët, e kanë dëshmuar pastërtinë e luftës dhe se ata vet, janë të pafajshëm”. “Deri kur kështu do të ndiqen ata që vunë gurëthemelin e shtetit të Kosovës. Nuk guxon askush të luaj me luftëtarët e lirisë, siç është njeriu që dha gjithçka për lirinë e vendit. Andaj, ne i themi Francës, që të mos bie pre e urdhrave serbe”, tha Lekaj, i cili në fund tha se “Kosova është e varfër pa Ramushin, pasi Ramushi është vet Kosova”.

Përfaqësuesi i degës së AAK-së në Malishevë, Bashkim Krasniqi, bëri thirrje për lirimin e Ramush Haradinajt dhe për ngritjen e akuzave për krimet serbe gjatë luftës në Kosovë. Ai më pas, tha se “Ramush Haradinaj, dy herë e ka mbrojtur luftën e UÇK-së në gjykatën ndërkombëtare, por kjo i pengon Serbisë, sepse pushka e Ramushit, ishte zjarr për ta”.

Edhe Sinan Gegaj, i cili foli në emër të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, në Malishevë, kërkoi lirimin e Ramush Haradinajt, pasi lufta e UÇK-së dhe e vet Ramushit, ka qenë e pastër



dhe e cila është dëshmuar nga vet këto shtete, siç është edhe Franca. Gegaj, pasi kërkoi, lirim të Ramush Haradinajt, “kërkoi nga institucionet e vendit, që të ndërpritet dialogu me shtetin serb, deri në njohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë dhe heqjen e të gjitha akuzave ndaj çlirimtarëve”.

## Malisheva, ndër komunat më të mira në realizimin e buxhetit

### Malishevë, 9 shkurt



Komuna e Malishevës, radhitet në mesin e komunave më të mira në vend, për realizimin e buxhetit komunal gjatë vitit 2016. Duke u bazuar në raportet përfundimtare të Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Komuna e Malishevës, e ka realizuar buxhetin, në shkallën 96.39 për qind. Sipas drejtorit të kësaj drejtorie, Vesel Krasniqi, është shënuar rritje edhe në inkasimin e të hyrave vetanake.

Sipas drejtorit Krasniqi, gjatë vitit 2016, ka pasur ngritje të investimeve kapitale dhe ulje në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht zvogëlim të shpenzimeve të “lluksit”. Komuna e Malishevës, në vitin 2016, ka pasur një buxhet prej 12.822,677.14 €, ndërsa buxheti i realizuar është 12,359,739 €, apo shprehur në përqindje, 96.39 për qind e buxhetit është realizuar.

“Në kategorinë e investimeve kapitale, krahasuar me vitin 2015, kemi pasur një ngritje të investimeve, për dyqind mijë euro më shumë, ndërsa kjo ngritje është edhe si rezultat i zbritjes së shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si zë buxhetor, pasi gjatë vitit 2016, Komuna e Malishevës, ka ulur shpenzimet për 108 mijë euro në këtë kategori”, tha drejtori Krasniqi. Sipas tij dhe sipas raporteve të nxjerra, ka ulje të dukshme të shpenzimeve në udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, pastaj ka ulje të shpenzimeve të derivateve.

“Ka ulje të shpenzimeve të “lluksit”, siç janë zvogëlimi i shpenzimeve të reprezentacionit për drejtorët e drejtorive, heqja e shpenzimeve të karburantit për drejtor dhe zvogëlimi i shpenzimeve tjera” tha Krasniqi, duke i treguar me shembuj, zvogëlimin e shpenzimeve të kategorisë për mallra e shpenzime.



Edhe në grumbullimin e të hyrave vetanake (THV), Komuna e Malishevës, ka shënuar rritje. “Përkundër pragut të lartë të përcaktuar nga ana e ministrisë, dhe kërkesës sonë të vazhdueshme për uljen e këtij pragu, por që nuk ka ndodhur, ne kemi realizuar 73 për qind të këtij pragu (pragu i përcaktuara ishte një milion e dhjetë mijë euro, të realizuara 740 mijë euro), ndërsa në raport me vitin paraprak, kemi realizuar 153 mijë euro më shumë”, ka sqaruar drejtori Krasniqi.

Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, ka thënë, se “përkundër bojkotit të vazhdueshëm gjatë këtyre tri viteve, nga ana e qeverisë qendrore, Komuna e Malishevës, vazhdon të investoj në të gjitha fshatrat dhe të shpenzoj maksimalisht buxhetin, bashkë me qytetarët e saj, prandaj edhe radhitemi në mesin e komunave më të mira në realizimin e buxhetit komunal”.

## **Ka filluar realizimi i disa projekteve**

### **Malishevë, 13 shkurt**

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, si çdo të hëne, ka mbajtur edhe sot mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, ku drejtorët e drejtorive, kanë prezantuar punën dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar, si dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje u bë e ditur se kanë filluar të realizohen disa projekte, ndërsa janë bërë edhe përgatitjet për shënimin e 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Fillimisht në mbledhjen e sotme, kryetari Begaj, ka kërkuar angazhim shtesë nga drejtoritë, pasi vitin 2017 e ka vlerësuar si një vit të ngarkuar me projekte, dhe kërkoi nga drejtorët e drejtorive, realizimin e plotë të planifikimeve të tyre për këtë vit.

Gjatë raportimeve të drejtorëve të drejtorive komunale, u bë e ditur se janë bërë përgatitjet për shënimin e 9 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ku aktivitetet kryesore do të jenë më datë 17 shkurt, si mbledhja solemne, homazhet dhe nderimet në vendet e caktuara, finalet në organizimet sportive, si dhe koncerti tradicional. Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Blerta Krasniqi, tha se “aktivitetet do të mbahen në harmoni me agjendën shtetërore për shënimin e 9 vjetorit të shtetësisë së Kosovës”.

Duke folur për realizimin e projekteve, drejtori për urbanizëm, Ahmet Morina, ka deklaruar se kanë filluar me realizimin e një projekti për ndërtimin e një trotuari në fshatin Carrallukë, si dhe me ndërtimin e dy rrugëve në Bellanicë. Ndërsa drejtori për bujqësi, Murat Hoxha, tha se janë në



përfundim të procedurave për realizimin projektit për ndërtimin e serrave, si dhe të projekteve tjera në fushën e bujqësisë.

Në fushën e shëndetësisë, drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, ka deklaruar se “brenda këtij muaji, pritet të filloj implementimi i projektit me Ministrinë e Shëndetësisë, për programin e SISH-it, ku nga tani do të filloj futja në sistem e vizitave shëndetësore”. Berisha, bëri të ditur se janë përgatitur edhe për sezonin e fushatave të vetëdijesimit, dezinfektimit dhe repelimit, si masa parandaluese ndaj EHKK.

Sa i përket arsimit, sipas drejtorit të arsimit, Avdi Morina, duke u bazuar në raportin e punës për vitin e kaluar, është shënuar rritje në suksesin e treguar nga nxënësit, si dhe është shënuar një ulje e mungesave nga nxënësit, kjo falë masave të ndërmarra nga ana e drejtorisë. “ Shqetësuese për neve si drejtori është rritja e rasteve të migrimit të nxënësve, pasi kjo dukuri është çdo ditë e më e theksuar”, tha Morina.

Në fushën e financave, drejtori për financa, Vesel Krasniqi, tha se “në bazë të raportit financiar, gjatë vitit të kaluar ka pasur rritje të të hyrave vetanake, por këtë vit, kjo rritje duhet të jetë edhe më e madhe dhe për këtë janë të përkushtuar si drejtori”.

## **Ka filluar ndërtimi i tri rrugëve në Bellanicë**

### **Malishevë, 14 shkurt**



Në fshatin Bellanicë të Komunës së Malishevës, ka filluar ndërtimi i tri rrugëve, brenda fshatit, përkatësisht të lagjeve në këtë fshat. Ndërtimi i rrugëve, po bëhet në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së rrugëve në vendbanimet e Komunës së Malishevës. Ndërtimin e rrugëve, e kanë parë nga afër kryetari i Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, gjatë vizitës në Bellanicë, i ka uruar banorët e këtyre lagjeve për rregullimin e rrugëve. “Ne po mundohemi që brenda mundësive tona, të investojmë në krijimin e kushteve më të mira për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, e në kuadër të këtyre përpjekjeve, janë edhe rrugët në fshatin tuaj”, tha kryetari Begaj.



Nga ana tjetër, drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, duke inspektuar punimet, tha se “punimet në fazën fillestare, janë duke shkuar sipas planifikimit dhe operatorët, janë duke ju përmbajtur kushteve të dhe projektit të përcaktuar nga ana e drejtorisë”. Drejtori Morina, tha se këto tri rrugë, do të jenë të shtruara me kubëza, ndërsa kanë një gjatësi prej rreth dy kilometrave dhe financohen nga buxheti komunal, dhe ka një kosto prej 68 382.5 eurove.

## Trotuar për nxënësit e Carrallukës

### Malishevë, 14 shkur



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme dhe krijimit të kushteve më të mira për jetesë, si lëvizja e lirë dhe siguria për nxënësit, në fshatin Carrallukë, ka filluar implementimi i projektit për ndërtimin e trotuarit, në pjesën më të madhe të fshatit, përkatësisht nga hyrja e fshatit, deri në shkollë, në mënyrë që nxënësit të kenë siguri gjatë udhëtimit nga shtëpitë në shkollë.

Ndërtimin e trotuarit, e kanë parë nga afër, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për urbanizëm, Ahmet Morina, të cilët janë shprehur të kënaqur me ecurinë e punimeve, ndërsa nxënësit dhe banorët e Carrallukës, i kanë uruar për këtë trotuar, i cili është në shërbim të tyre.

“Krahas investimeve në shkolla, për krijimin e kushteve më të mira për mësim, ne jemi të obliguar të krijojmë edhe kushte që rrisin sigurinë e fëmijëve tanë, dhe në kuadër të këtij angazhimi kemi filluar me ndërtimin e trotuarit, që kalon në pjesën më të madhe të fshatit, me qëllim që fëmijët të jenë të sigurt gjatë udhëtimit të tyre nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, pasi ka inspektuar punimet, tha se edhe ky projekt është duke shkuar sipas planifikimit, ndërsa kushtet atmosferike, na kanë mundësuar që të fillojmë tani me projektin dhe besoj që në kohë rekorde do të përfundoj edhe ky projekt, i cili ka rëndësi të madhe për të gjithë banorët, e në veçanti për nxënësit e këtij fshati, të cilët vijojnë mësimin në shkollën “Imer Krasniqi”. “Projekti financohet nga Komuna e Malishevës, ndërsa trotuari ka një gjatësi prej 1150 metrave, dhe kosto e ndërtimit kap një shumë prej 39 235.88 euro”, sqaroi Morina.



## KPF mbajti mbledhjen e dytë për këtë vit, ku dha disa rekomandime

### **Malishevë, 14 shkurt**

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të rregullt për këtë vit. Pas shqyrtimeve të pikave të rendit të ditës, KPF ka dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e në mesin e tyre, edhe raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin e kaluar.

KPF, pas shqyrtimit, ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, informimin e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, lidhur me përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2016/2017m, si dhe për përgatitjet për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë të këtij viti shkollor. Rekomandim tjetër për KK, ishte edhe Plani i Punës së Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, për vitin 2017.

KPF, në mbledhjen e sotme, ka rekomanduar për mbledhjen e kuvendit, edhe raportin e të hyrave dhe shpenzimeve komunale, gjatë vitin 2016, përkatësisht raportin vjetor financiar. KPF, ka shqyrtuar edhe kërkesat e drejtuara në adresë të këtij komiteti.

## Sot ka filluar faza e dytë e vizitave sistematike në shkollat e Malishevës

### **Malishevë, 15 shkurt**



Nga sot, ka filluar faza e dytë e realizimit të projektit të vizitave sistematike në shkollat e Komunës së Malishevës. Ky projekt realizohet me qëllim të monitorimit të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe identifikimit të problemeve potenciale shëndetësore. Realizimin e këtij projekti, e kanë parë nga afër, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha dhe ai i arsimit, Avdi



Morina.

Kryetari Begaj, i ka përshëndetur dhe i ka uruar punëtorët shëndetësor të QKMF të Malishevës, për këtë punë të jashtëzakonshme, që janë duke bërë, për kujdesin e shëndetit të fëmijëve në Komunën e Malishevës.

Sipas Valbona Gashit, kryetëknike në QKMF të Malishevës, në fazën e parë të këtyre vizitave janë përfshi 900 nxënës të shkollave të Komunës së Malishevës, ndërsa në fazën e dytë do të përfshihen edhe 3000 nxënës, për ti përmbyllur vizitat. Gashi ka thënë se “qëllimi i të gjitha vizitave, është të monitorohet rritja dhe zhvillimi i fëmijëve, njëkohësisht të identifikohen problemet potenciale shëndetësore dhe të udhëzohen me kohë në kujdesin sekondar apo terciar. Gjatë vizitave mjekësore tek të gjithë nxënësit kontrollon: pesha, gjatësia, higjiena, sistemi lokomotor, kafazi i kraharorit, sistemi i të pamurit, dëgjimi, shëndeti oral, sistemi kardiovaskular, sistemi respirator, abdomen dhe sistemi nervor qendror. Projekti përfshinë 43 shkolla të komunës sonë dhe pritet të finalizohet nga fundi i muajit mars”.

## **Formohet sindikata e punëtorëve të administratës komunale**

### **Malishevë, 15 shkurt**

Sot, është formuar Sindikata e Punëtorëve të Administratës në Komunën e Malishevës. Sindikata e mëparshme ka qenë jo funksionale dhe ndër të rrallët në nivel vendi, punëtorët e administratës komunale në Malishevë, nuk kanë qenë të organizuar. Kryetar i sindikatës, është zgjedhur Jakup Zulfaj, si dhe janë zgjedhur organet tjera të sindikatës.

Në mbledhjen e sotme me punëtorët e administratës, morën pjesë edhe Ndue Kala, kryetar i SPAK, i shoqëruar edhe nga anëtarët tjerë të kryesisë së SPAK dhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Fillimisht, kryetari Begaj, duke i përshëndetur punëtorët për organizimin e tyre sindikal, “uroi që sindikata të mbroj të drejtat e punëtorëve dhe të kryej punën e saj në mënyrë të pavarur dhe e pa ndikuar politika”. Kryetari Begaj, premtoi se do të bashkëpunoj me sindikatën.

Ndërsa kryetari i SPAK, i njoftoi punëtorët me të drejtat e tyre dhe me ligjin për organizimin sindikal, si dhe me rregulloret e SPAK.

Më pas, është zgjedhur kryetari i sindikatës, Jakup Zulfaj, pastaj dy nënkryetarët, Emine Krasniq dhe Eset Begaj, sekretar është zgjedhur Xhevdet Mazreku, ndërsa anëtar tjerë të kryesisë u



zgjodhën edhe Haxhi Krasniqi, Azem Gashi dhe Fatime Kastrati. Delegat në kuvendin e SPAK, u zgjodhën Naser Morina dhe Fehmi Krasniqi.

## Aktivitete të shumta në prag të shënimit të Pavarësisë

### Malishevë, 16 shkurt



Në vigjilje të shënimit të nëntë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Malishevë, krahas organizimeve të komunës, janë organizuar një varg aktiviteteve, sidomos në institucionet shkollore. Në mesin e këtyre aktiviteteve, edhe çerdhja në Malishevë, ka vizituar komunën, ku janë pritur nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Fëmijët, me këtë rast, kishin sjellë punime të bëra në çerdhe, e të cilat i kushtohen 17 Shkurtit, Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, si dhe kanë recituar vjersha. “Kjo është vizita më e veçantë për mua dhe unë ju falënderoj për këtë aktivitet dhe jam shumë i kënaqur me aktivitetin tuaj”, tha kryetari Begaj.

Po ashtu sot, edhe shkolla “17 Shkurti” në Banjë dhe “Kajtaç Ramadani” në Kijevë, i kanë shënuar ditët e shkollave të tyre. Në këto aktivitete, kanë marrë pjesë edhe kryetari Begaj dhe drejtori i arsimit, Avdi Morina, të cilët i kanë përshëndetur dhe uruar këto shkolla.

Nga ana tjetër, organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, janë duke u mbajtur aktivitetet sportive, të cilat pritet të përfundojnë nesër.

Gjatë ditës së nesërme, në Malishevë, do të zhvillohen aktivitetet tjera, si mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Malishevës, pastaj nderime dhe homazhe, koncerti tradicional dhe finalja në turnirin e futsallit.

## Malisheva shënoi nëntë vjetorit e Pavarësisë

### Malishevë, 17 shkurt



Komuna e Malishevës, përmes aktiviteteve të ndryshme, ka shënuar nëntë vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Aktivitetet e Komunës së Malishevës, filluan me mbajtjen e një seance solemne të Kuvendit të Komunës së Malishevës, ku fjalë rasti kanë mbajtur, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi dhe kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Metush Kryeziu.

Në këto fjalime të rastit, u vlerësua sakrifica popullit shqiptar të Kosovës, në përpjekjet për liri dhe shtetësi. Në këtë drejtim, edhe përpjekjet dhe kontributi i Malishevës, në luftën për liri dhe për shtet, si përpjekjet për zhvillim, u vlerësuan lartë, ku kontributi i Malishevës, ishte i jashtëzakonshëm, sidomos në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Aktivitetet e Komunës së Malishevës, kanë vazhduar sipas agjendës, me homazhe dhe nderime të shtatorja e Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, në “Sheshin e Dëshmorëve” në Malishevë, pastaj homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevës, nderime dhe homazhe në Prekaz, si dhe homazhe në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë.

Më pas, në parkun e qytetit në Malishevës, është organizuar një koncert i madh, me artist nga Komuna e Malishevës dhe me artist nga estrada kosovare, ndërsa nga ora 15:00, luhet edhe finalja në turnirin në futsall.

Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me rastin e shënimit të nëntë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës:

*Sot jemi këtu, në këtë seancë solemne, për të shënuar nëntë vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, dhe unë jam i nderuar që të mbaj këtë fjalim rasti para juve të nderuar të pranishëm.*

*Sot u bënë nëntë vite nga Shpallja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, shtet sovran dhe i pavarur.*

*Bazuar në histori, të gjitha të arriturat e shqiptarëve janë bërë pas sakrificave, betejave dhe luftërave në periudha të ndryshme kohore. Në kontekstin historik, që nga periudha e*



*Skënderbeut, për të ardhur në kohën e Ismail Qemalit, përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe pavarësi, mbetën të pakurorëzuara plotësisht, pasi pjesët e mbetura jashtë Shqipërisë, duke përfshirë edhe Kosovën, mbetën të okupuara nga pushtuesit, pothuajse edhe plot një shekull.*

*U bënë shumë përpjekje politike, u bënë shumë organizime të ndryshme, për të ardhur deri tek organizimi ushtarak, si mjeti i fundit i përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi. Pas luftës së fundit, u bënë edhe shumë përpjekje diplomatike, për të ardhur në vitin 2008, kur edhe përfundimisht u bë shpallja e Pavarësisë së Kosovës..*

*Gjatë këtyre përpjekjeve tona si popull, për të fituar pavarësinë, në të njëjtën kohë, ne kemi punuar në ndërtimin e vendit dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët tanë.*

*Në këto përpjekje, qoftë politike, qoftë ushtarake, ashtu edhe në ndërtimin e vendit, pa dyshim se edhe Malisheva, kishte dhënë kontributin e saj, madje si komunë, apo si rrethinë edhe jemi sakrifikuar si popullatë, apo si banorë të kësaj pjese të vendit. Dashuria për vendin, gatishmëria për sakrificë dhe vetëmohim, si dhe pozita gjeografike, na kanë bërë që të jemi në shërbim të interesave kombëtare.*

*Para luftës së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Malisheva, i ka dhënë shumë vendit, madje, madje, Malisheva ka qenë komuna e parë në vend, që në mënyrë publike dhe institucionale, e ka kundërshtuar sistemin e atëhershëm shtetëror-komunist. Por në këtë kohë, komunës sonë, ju hoq statuti i komunës, mirëpo ne vazhduam në sistemin paralel të organizimit.*

*Më 1998, filloi edhe organizimi i rezistencës ushtarake, dhe Malisheva, si asnjë vend tjetër, ju bashkua thirrjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari, për të luftuar deri në çlirimin e vendit. Në këtë luftë, Malisheva, përsëri i dha shumë vendit, duke u organizuar në dy brigada të mëdha ushtarake. Në luftën çlirimtare, Malisheva i dha vendit afro 80 dëshmorë, qindra banorë tjerë humbën jetën, u bënë masakra të shumta, dhjetëra të zhdukur, e shumë luftëtarë mbetën invalid.*

*Më 16 Qershor, Malisheva u çlirua, por nga kjo luftë doli tërësisht e shkatërruar. Pas çlirimit, Malisheva, punoi shumë në ndërtimin e saj, dhe krahas ndërtimit, u punua shumë edhe në ngritjen e institucioneve komunale dhe zhvillimit të komunës, krahas zhvillimit të vendit në përgjithësi.*

*U punua shumë, deri në ardhjen e 17 Shkurtit të vitit 2008, kur edhe Kuvendi i Kosovës, miratoi Deklaratën e Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.*

*Sot, në 9 vjetorin e Pavarësisë, dhe në vitin e katërt të detyrës sime, si Kryetar i Komunës, po bëjmë përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë dhe po bëjmë gjithçka që është e mundur që qytetari ynë, të ndihet komod dhe dinjitoz në vendin e vet.*



*Urojmë, që shumë shpejt, Kosova të ketë vendin e saj të merituar në instancat ndërkombëtare, krahas vendeve tjera të lira të botës.*

*Më lejoni që me këtë rast, ti uroj të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës.*

**GËZUAR DITA E PAVARËSISË SË KOSOVËS**

## **Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Malishevë, shënoi ditën e themelimit**

### **Malishevë, 17 shkurt**



dhe i kanë uruar për punën që ata bëjnë.

Me një ceremoni rasti të organizuar nga Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (SHZSH), është shënuar 17 vjetori i formimit të kësaj njësie në Malishevë, dhe Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Në këtë ceremoni rasti, morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtimit, Sejdi Paçarizi, të cilët i kanë përshëndetur pjesëtarët e këtij shërbimi, si

“Ju jeni njëra prej shërbimeve më të mira dhe në të njëjtën kohë jeni ata që tash e 17 vite jeni në shërbim të qytetarëve të Komunës së Malishevës dhe më gjerë. Jeni njëra prej njësive më të mira në nivel vendi dhe këtë e keni dëshmuar në shumë raste. Unë shfrytëzoj rastin që t’iu uroj juve me rastin e themelimit të njësisë dhe në të njëjtën kohë, t’iu uroj edhe Shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës”, tha mes tjerash në fjalën e rastit, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Edhe drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtimit, Sejdi Paçarizi, i ka uruar të gjithë pjesëtarët e njësisë së SHZSH-së, me rastin e 17 vjetorit të themelimit dhe i ka përgëzuar për punën që po bëjnë në shërbim të qytetarëve.

Nga ana tjetër edhe udhëheqësi i njësisë së SHZSH-së në Malishevë, Aziz Telaku, i ka uruar të gjithë pjesëtarët e kësaj njësie me rastin e përvjetorit të themelimit, si dhe i ka përgëzuar për punën që po bëjnë. Po ashtu, Telaku, i përshëndetur edhe kryetarin Begaj dhe drejtorin Paçarizi, për pjesëmarrje, të cilët në çdo situatë, janë përkrahë pjesëtarëve të SHZSH-së.



## Filloi hapja dhe rregullimi i dy rrugëve në Pagarushë

### Malishevë, 23 shkurt



Pagarushës.

Fshati Pagarushë në Komunën e Malishevës, njihet si një nga fshatrat me shpërndarjen më të madhe të lagjeve dhe me largësi të gjatë mes lagjeve, si dhe me një terren të bukur, por të ashpër. Si rezultat i kësaj, disa nga shtëpitë e lagjeve, gjenden larg rrugëve të asfaltuara dhe përballen me probleme serioze gjatë lëvizjeve të tyre. Për këtë qëllim, Komuna e Malishevës, ka filluar rregullimin e dy rrugëve, në dy lagje të

Hapjen e këtyre rrugëve, sot e ka inspektuar drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Ahmet Morina. Me këtë rast, Morina, është takuar me banorët e këtyre lagjeve, si dhe me punëkryesin. Përderisa banorët i ka uruar për rrugën, edhe me punëkryesin është ndarë i kënaqur, me ecurinë e punimeve që është duke i bërë, edhe pse këto punime kryhen në një terren mjaftë të vështirë.

“Qëllim i yni, nuk është thjeshtë realizimi i projekteve të cilat parashihen të realizohen brenda një viti pune, por është krijimi i kushteve sa më të mira, për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, e në veçanti në fshatrat e thella, siç janë lagjet Dukoç dhe Rexhaj të Pagarushës”, tha Morina.

“Këto dy rrugë kanë një gjatësi prej 700 metrave, ndërsa punimet që do të kryhen këtu janë, hapja e rrugës, krijimin e bazës për asfaltim dhe në fund asfaltimi i tyre”, tha Morina.

Banorët e këtyre lagjeve, e kanë falënderuar Komunën e Malishevës, për këto investime dhe për kujdesin e vazhdueshëm. Banorët e këtyre lagjeve, thanë se “hapja e rrugëve, ju mundëson atyre lëvizje më të lehtë dhe rrugët e tyre lidhen me rrugët kryesore, dhe rrjedhimisht ju lehtëson jetesën e tyre në fshat”.



## **KKSB miratoi planin e punës për vitin 2017**

### **Malishevë, 23 shkurt**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2017. Mbledhja e sotme, është drejtuar nga drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi. Ndër çështjet e trajtuara në mbledhjen e sotme, ishte edhe plani i punës së KKSB-së për vitin 2017, plan i cili është miratuar nga ana e anëtarëve të KKSB-së.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të KKSB-së, situata e sigurisë së përgjithshme u vlerësua e qetë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë.

## **U mbajt mbledhja e dytë e KK të Malishevës**

### **Malishevë, 24 shkurt**



Kuvendi i Komunës së Malishevës, nën drejtimin e kryesuesit të saj, Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e dytë të radhës, për këtë vit. Në këtë mbledhje ndër çështjet e shqyrtuara, ishte edhe raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2016, si dhe shpallja e një zonë në fshatin Lladrovc, zonë me interes publik, me qëllim të ndërtimit të shkollës në këtë fshat.

Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve komunale, e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Vesel Krasniqi, i cili tha se buxheti është shpenzuar në mënyrën më të mirë të mundshme, ndërsa janë ulur shpenzimet komunale, si dhe janë rritur të hyrat vetanake. Pas raportimit, anëtarët e kuvendit, kanë dhënë vlerësimet e tyre lidhur me raportin.

Gjithashtu, pas raportimit dhe prezantimit të raportit të punës dhe planit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve, anëtarët e KK të Malishevës, me shumicë të votave, e kanë miratuar këtë raport dhe këtë planifikim për vitin 2017. Edhe për komitetin për arsim, kulturë, rini dhe sport, anëtarët e KK, e kanë miratuar planin e punës për vitin 2017.



Pikë me rëndësi në këtë mbledhje ishte miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për shpalljen zonë me interes publik, të një zone në fshatin Lladrovç, me qëllim të ndërtimit të shkollës në Lladrovç. Kjo ishte edhe kërkesë e vet banorëve dhe kryesisë së fshatit, si dhe drejtorisë së shkollës dhe drejtorisë komunale të arsimit.

Për gjendjen në arsim, përkatësisht informim për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2016/2017, si dhe përgatitjet për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/2017, ka informuar drejtori i drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, i cili foli për disa të arritura në pjesën e parë të vitit shkollor, si dhe përgatitjet për gjysmë vjetorin e dytë, përfshi edhe investimet në shkolla, në veçanti për rritjen e cilësisë në shkolla.

KK i Malishevës, në mbledhjen e sotme, pas shqyrtimit ka miratuar disa kërkesa të qytetarëve për ndërrim destinim të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore, si dhe një kërkesë e fshatit Bubavec, për ndërtimin e një sheshi.

## **Begaj në Dusseldorf, prezantoi ofertën e Malishevës për investime**

### **Dusseldorf / Malishevë, 27 shkurt**



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me ftesë të Unionit të Bizneseve shqiptaro-gjermane, po qëndron në Dusseldorf të Gjermanisë, në një takim të organizuar nga ky union. Në takimet e zhvilluara gjatë fundjavës, kryetari Begaj, ka prezantuar ofertat dhe kushtet e Komunës së Malishevës. për investime. Këtë prezantim Begaj, e ka bërë gjatë fjalimit të mbajtur në takimin e unionin, me bizneset shqiptare dhe gjermane, anëtare të Unionit të Bizneseve shqiptaro-gjermane.

Në këtë takim krahas bizneseve të fuqishme shqiptare dhe gjermane, kanë marr pjesë edhe përfaqësuesit e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Frankfurt, pastaj edhe biznesmen të njohur nga Komuna e Malishevës, siç ishte Bekim Bytyçi, nga Shkoza, që vepron në Gjermani dhe është një prej biznesmenëve më të njohur dhe më me autoritet.

Kryetari Begaj, gjatë prezantimit të tij, i ka njoftuar bizneset për mundësitë që ka Malisheva për investime, si dhe për lehtësirat që ofron Komuna e Malishevës, për ata që duan të investojnë në Malishevë.



## Shënohet rasti i parë i thumbimit të rriqrave për këtë vit

### **Malishevë, 27 shkurt**

Gjatë kësaj fundjave, është shënuar rasti i parë i thumbimit nga rriqrat në territorin e Komunës së Malishevës, për këtë vit. Kështu ka raportuar drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Hajdin Berisha, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. “Gjatë fundjavës, është shënuar edhe rasti parë i thumbimit nga rriqrat, por është thjeshtë thumbim dhe nuk ka vend për shqetësim”, tha Berisha.

Po ashtu Berisha, ka bërë të ditur se, si drejtori janë përgatitur dhe kanë marrë masat e nevojshme, brenda kompetencave, për fushatat si masa mbrojtëse ndaj etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). Në tri vitet e fundit, në territorin e Komunës së Malishevës, nuk janë regjistruar raste të vdekjeve nga EHKK, ndërsa në vitin 2016, nuk është regjistruar asnjë rast i infektimit me EHKK.

Përndryshe në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Raxhep Mazreku, u raportua për përgatitjet për fillimin e realizimit të projekteve, sipas listës së projekteve kapitale. Mirëpo për zhvillimin e procedurave të prokurimit, Komuna e Malishevës, është duke u përballur me probleme në sistemin e ri të prokurimit të publik.

Drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, gjatë raportimit të tij, i ka shfaqur dy probleme me të cilat është duke u përballur Malisheva, e para mosfunksionimi i mirë i sistemit elektronik të prokurimit publik (shqetësim ky i shfaqur edhe me fillimin e implementimit të këtij sistemi), si dhe mos alokimi i mjeteve nga të hyrat vetenake, nga thesari në qendër, që sipas drejtorit Krasniqi, “kjo është shumë shqetësuese”.

Drejtori për administratë, ka njoftuar se është shtuar në masë të madhe numri i qytetarëve të cilët kërkojnë certifikata, por shërbimet komunale janë të përgatitura dhe ju ofrohen shërbime të shpejta dhe pa probleme të gjithë qytetarëve.

Drejtori i Arsimit, ka paraqitur edhe njëherë problemin e mbajtjes së teksteve mësimore të vjetra, në hapësirat e shkollave, kryesisht në çatitë e shkollave, pasi kjo mund të paraqes rrezik permanent dhe rrjedhimisht rrezikohet siguria e nxënësve në shkolla, mirëpo me gjithë kërkesat e vazhdueshme, MASHT-i ende nuk ju ka dhënë një sqarim drejtorive, se si të veprojnë për largimin e tyre, pasi ato tekste janë të MASHT-it.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, u raportua për përgatitjet për shënimin e 5,6 dhe 7 Marsit ditët e “Epopesë së UÇK-së” si dhe Ditës së Mësuesit.



## Begaj, takoi humanistin gjerman Rudolf Broer

### Malishevë, 27 shkurt



Në kuadër të qëndrimit të tij në Gjermani, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, gjatë ditës së sotme, është takuar me humanistin dhe biznesmenin e njohur gjerman, Rudolf Broer, i cili kohë më parë kishte dhënë disa donacione me rëndësi për Komunën e Malishevës, ndërsa ka premtuar se do të vazhdoj me përkrahjen e tij për popullatën e Malishevës.

Kryetari Begaj, edhe njëherë e ka falënderuar humanistin Broer për donacionet e sjella në Malishevë, ku përmes përkrahjes së tij, sot disa nga personat me aftësi të kufizuara lëvizin, sepse ka siguruar dhjetëra karroca për ta, ndërsa edhe personat në hemodializë, i kryejnë shërbimet e dializës, falë një kombi busi të dhuruar nga Rudolf Broer.

Nga ana tjetër, humanisti Broer, gjatë bisedës me kryetarin Begaj, ka premtuar se do të angazhohet përsëri për Malishevës, në fushën e shëndetësisë dhe arsimit, duke dhënë donacione në këto fusha.

Kryetari Begaj, gjatë ditës së sotme, do të takohet edhe me zyrtarë të komunave në Gjermani, në mesin e tyre edhe me kryetarin e Komunës së Sundernit, Rahpl Brodel, i cili në fund të shtatorit të vitit të kaluar, kishte vizituar Malishevës, ndërsa bashkëpunimi me këtë komunë, vazhdon tash e disa vite me radhë.

## Sunderni dhe Malisheva, vazhdojnë bashkëpunimin e mirë

### Sundern/Malishevë, 28 shkurt

Në kuadër të vizitë së tij në Gjermani, me ftesë të Unionit të Bizneseve shqiptaro-gjermane, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dje pasdite ka vizituar qytetin e Sundernit, qytet në të cilin jetojnë një numër i madh i mërgimtarëve tanë, ndërsa Komuna e Malishevës, ka një bashkëpunim të mirë dhe si rezultat, Sunderni do të përkrahë Malishevën.



Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, është takuar me kryetarin e Sundernit, Rahpl Brodel, me të cilin kanë biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm, ndërsa kryetari i Sundernit, Brodel, e ka njoftuar kryetarin Begaj, se e ka mbajtur premtimin e dhënë gjatë vizitës së tij në Malishevë, në shtator të vitit të kaluar, për sigurimin e një makine për mirëmbajtjen e kanalizimeve.

Gjatë vizitës në Malishevë, kryetari i Sundernit, Rahpl Brodel, ishte shprehur i mahnitur me të arriturat, që për një kohë të shkurtër pas lufte, ishin bërë gjithë ato investime në sistemet e ujësjellësve dhe kanalizimeve, dhe ishte zotuar se do angazhohej për sigurimin e një makine, për pastrimin e kanalizimeve, makineri e cila mungon në vendin tonë, si dhe do të përkujdesen për trajnimin e punëtorëve që do të

punojnë me atë makinë.

Begaj e Brodel, kanë biseduar edhe për vazhdimin dhe rritjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe kulturës, ku gjatë muajit mars do të zhvillohen takime të përbashkëta mes Malishevës dhe Sundernit, në nivel të drejtorive përkatëse.

Gjatë kësaj vizite, kryetari Begaj, është shoqëruar nga Fadil Bytyçi, kryetar i klubit të shqiptarëve “2 Korriku”, si dhe zyrtari në drejtorinë komunale të arsimit, Shefqet Kryeziu.

Përndryshe, në këtë pjesë të Gjermanisë, jetojnë një numër i madh i mërgimtarëve tanë, të cilët janë të inkuadruar mirë në jetën shoqërore dhe kulturore, dhe të cilët kanë krijuar imazhin më të mirë të mundshëm për Kosovën në përgjithësi dhe për Malishevën në veçanti. Në Sundern, në nëntor të viti 2011, është vendosur edhe shtatorja e “Nënë Terezës”, prej kur edhe ka filluar bashkëpunimi mes Malishevës dhe Sundernit, bashkëpunim i cili vazhdon edhe sot.